



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 306/2 prot

Gramsh, më 03/02/2023

VENDIM
Nr. 3, dt, 30.01.2023

Për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim të një pjese të objektit me emërtimin “Y”, familjes së shtetasit Myftar Mema.

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e datës 30.01.2023, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transpotit, strehimit dhe emergjencave civile, “Për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim të një pjese të objektit me emërtimin “Y”, familjes së shtetasit Myftar Mema, banues në fshatin Pishaj, Njësia Administrative Pishaj”, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, nenet 19,63, 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe ,të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2; neni 54, gërma “e” :

V e n d o s i:

- I. Të miratojë dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim të ambientit me sipërfaqe 60 m² në objektin me emërtimin “Y” me numër pasurie 155/3, Zona Kadastrale 2167 , në fshatin Kocaj, për banim familjes së z.Myftar Mema .
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Xhulia Gjini

Konc.Xh.Gjini
Konf.G.Lena
Dosja: _____
Afati I ruajtjes: _____



Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Greta LENA